



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Autoriteti Kosovar i Konkurrencës
Autoritet Kosova za Konkurenciju - Kosovo Competition Authority

Në bazë të nenit 28 paragrafi 1.1, të Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës Ligji nr. 03/L-229, (Gazeta zyrtare nr. 88, dt. 25.11.2010) si dhe neni 4 dhe 7A, paragrafi 2 i Plotësim Ndryshimit të Ligjit 04/L-226 Komisioni i Autoriteti Kosovar i Konkurrencës me **dt. 21.11.2017** nxjerr këtë:

UDHËZIM ADMINISTRATIV NR.02/2017

PËR PËRJASHTIMIN GRUPOR TË MARRËVESHJEVE

HORIZONTALA NDËRMJET NDËRMARRËSVE

DISPOZITAT E PËRGJITHSHME

Qëllimi

Neni 1

Me këtë Udhezim Administrative përcaktohen kushtet që marrëveshjet horizontale ndërmjet ndërmarrësve duhet të përmbajnë, kufizimet dhe kushtet që këto marrëveshje nuk duhet të përmbajnë, që të jenë të përjashtuara nga ndalimet e përgjithshme nga neni 4, paragrafi 1 i Ligjit për mbrojtjen e konkurrencës (në tekstin e mëtejshëm: Ligji).

Përkufizimet

Neni 2

Në këtë Udhezim Administrativ termet e mëposhtme kanë këto kuptime:

- a) *marrëveshje horizontale* është kontratë, një dispozitë e caktuar e kontratës, marrëveshje me gojë apo me shkrim, praktikat e bashkërenduara që rezultojnë nga marrëveshjeve të tilla, vendime të ndërmarrësve apo të grupeve të ndërmarrësve, kushtet e përgjithshme të biznesit dhe aktet tjera të ndërmarrësve, që janë ose mund të jenë pjesë përbërëse e marrëveshjes dhe të ngjashme, të arritura ndërmjet dy apo më tepër ndërmarrësve të pavarur të cilët veprojnë në nivel të njëjtë të prodhimit, gjegjësisht distribuimit, dhe të cilëve u rregullohen kushtet me të cilët palët e marrëveshjes mund të blejnë, shesin apo rishesin mallrat dhe/apo shërbimet e caktuara;

b) *kufizimi horizontal* është kufizim i konkurrencës që është pjesë e marrëveshjes horizontale nga pika a) e këtij neni që është e përfshirë në nenin 4, paragrafi 1 i Ligjit;

c) *ndërmarrës* është personi nga neni 2 i “Plotësim ndryshimit të Ligjit;03/L-226 për mbrojtjen e konkurrencës

e) *produkti* është term juridiko/teknik për mallrat dhe/apo shërbimet duke përfshirë edhe mallrat dhe/apo shërbimet gjysmë të gatshme dhe produktet dhe/apo shërbimet finale;

f) *në marrëveshjet për specializim* produkte nuk konsiderohen shërbimet e distribuimit dhe huazimit;

g) *produkti zëvendësues (substitut)* është produkti i cili duke marr parasysh karakteristikat a tij thelbësore, çmimin apo mënyrën e përdorimit ose shprehitë e konsumatorëve mund të zëvendësojë një produkt tjetër (përkatës) dhe në këtë mënyrë të plotësojë nevojat ekuivalente të blerësit dhe/apo konsumatorit;

h) *tregu relevant/përkatës* - fushën e tregtisë për të cilën konkurrenca është kufizuar në një zonë të caktuar gjeografike, duke përfshirë të gjitha produktet dhe shërbimet e zëvendësueshme për të cilat konsumatorët mund të drejtohen në afat sa më të shkurtër, në rast se kufizimi apo abuzimi rezulton në ngritjen e çmimit;

i) *tregu përkatës i produktit në marrëveshjet për specializim* është tregu përkatës i prodhimit dhe ai gjeografik, i cili përbën objektin e marrëveshjes për specializim, dhe mund të përcaktohet edhe më gjerë, në rast se këto produkte që janë objekt i marrëveshjes për specializim janë produkte gjysmë të gatshëm, të cilët njëra apo më shumë palë të marrëveshjes i përdorin në tërësi apo pjesërisht në prodhim e tyre të produkteve zbritëse, dhe atëherë tregu përkatës i produkteve përfshin edhe tregun prodhimit edhe tregun gjeografik, të cilit i takojnë këta produkte zbritëse;

j) *produkt zbritës* është produkt të cilin njëra apo më shumë palë të marrëveshjes për specializim e prodhojnë dhe e shesin në treg, dhe gjatë prodhimit të produkteve zbritëse si gjysme produkt përdorin produktin që është objekt i marrëveshjes për specializim;

k) *tregu përkatës i produkteve në marrëveshjet për kërkim dhe zhvillim* është tregu përkatës i produkteve të cilët mund të përmirësohen, ndryshohen apo zëvendësohen me produktet që janë objekt i marrëveshjes;

l) *tregu përkatës i teknologjive në marrëveshjet për kërkim dhe zhvillim* nënkupton tregun përkatës të teknologjive dhe proceseve që mund të përmirësohen, ndryshohen apo zëvendësohen me teknologjitë që janë objekt i marrëveshjes;

m) *konkurrent* është një emër i përbashkët për konkurrentët real apo të mundshëm;

n) *konkurrent real i palës së marrëveshjes për specializim* është ndërmarrësi që vepron në tregun përkatës të njëjtë;

o) *konkurrent real i palës së marrëveshjes për kërkim dhe zhvillim* është ndërmarrësi që shpërndan një produkt, teknologji apo proces, i cili mund të përmirësohet, ndryshohet apo zëvendësohet me produktin apo teknologjinë e kontraktuar në tregun përkatës gjeografik;

p) *konkurrent i mundshëm i palës së marrëveshjes për specializim* është ndërmarrësi i cili do të mund që, pa ekzistuar marrëveshja për specializim, në baza reale e jo vetëm në bazë të një mundësie të thjeshtë teorike, në rast të rritjes së vogël, por të pandërprerë të çmimeve relative, në një afat jo më të gjatë se tre vjet, të ndërmarrë investime të domosdoshme shtesë apo shpenzime tjera të domosdoshme të zëvendësimit për të hyrë në tregun përkatës;

r) *konkurrent i mundshëm i palës së marrëveshjes për kërkim dhe zhvillim* është ndërmarrësi i cili do të mund, pa ekzistuar marrëveshja për kërkim dhe zhvillim, në baza reale e jo vetëm në bazë të një mundësie të thjeshtë teorike, në rast të rritjes së vogël, por të pandërprerë të çmimeve relative, në një afat jo më të gjatë se tre vjet, të ndërmarrë investime të domosdoshme shtesë apo shpenzime tjera të domosdoshme të zëvendësimit, në mënyrë që të shpërndajë produktin, teknologjinë apo procesin i cili mund të përmirësohet, ndryshohet apo zëvendësohet me produktin apo teknologjinë e kontraktuar në tregun përkatës gjeografik;

s) *blerësi* është ndërmarrësi i cili blen produktin nga furnizuesi, për ta instaluar në produktin e ri të cilin ky blerës e prodhon dhe/apo e blen produktin nga furnizuesi për qëllim të stërshitjes së mëtejme tek blerësi tjetër apo konsumatori final, gjegjësisht konsumatori;

t) *blerësi i tërthortë* është ndërmarrësi i cili nuk është palë e marrëveshjes horizontale, dhe blen mallra dhe/apo shërbime që janë objekt i marrëveshjes nga blerësi i cili është palë e marrëveshjes horizontale;

u) *konsumatori* është person fizik i cili blen, gjegjësisht përdor apo në një situatë të caktuar do të mund të përdor produktin përkatës.

Marrëveshjet në të cilat zbatohet përjashtimi grupor

Neni 3

(1) Përjashtimi grupor zbatohet në marrëveshjet horizontale nga neni 5, i Ligjit, dhe nenit 7A të Plotësim ndryshimit të ligjit Nr.04/L-226, të arritura ndërmjet dy apo më tepër ndërmarrësve të cilët veprojnë në një nivel të njëjtë prodhimi, gjegjësisht distribuimi, e veçanërisht në:

a) marrëveshjet për kërkim dhe zhvillim,

b) marrëveshjet për specializim.

(2) Marrëveshja për kërkim dhe zhvillim nga paragrafi 1, pika a) e këtij neni është marrëveshje e arritur ndërmjet dy apo më tepër ndërmarrësve të pavarur, me të cilën janë rregulluar kushtet nën të cilët këta ndërmarrës kryejnë:

a) kërkim dhe zhvillim i përbashkët i produkteve apo teknologjive të kontraktuara dhe përdorim i përbashkët i rezultateve të këtyre kërkimeve dhe zhvillimit,

b) përdorim i përbashkët i rezultateve të kërkimit dhe zhvillimit të produkteve apo teknologjive të kontraktuara deri tek të cilët kanë ardhur bashkërisht në përputhje me marrëveshjen paraprake ndërmjet ndërmarrësve të njëjtë,

c) Kërkim dhe zhvillim i përbashkët i produkteve apo teknologjive të kontraktuara pa përdorimin e përbashkët të rezultateve të këtyre kërkimeve dhe zhvillimit,

d) Kërkim i paguar dhe zhvillim i produkteve apo teknologjive të kontraktuara dhe përdorim i përbashkët i rezultateve të këtij kërkimi dhe zhvillimi,

e) përdorim i përbashkët i rezultateve të kërkimit të paguar dhe zhvillimit të produkteve apo teknologjive të kontraktuara në përputhje me marrëveshjen paraprake ndërmjet palëve të njëjta të marrëveshjes, apo

f) kërkim i paguar dhe zhvillim i produkteve apo teknologjive të kontraktuara pa përdorim të përbashkët të rezultateve të këtyre kërkimeve dhe zhvillimit.

(3) Me termin kërkim dhe zhvillim i përbashkët nga paragrafi 2 i këtij neni, konsiderohen aktivitetet të cilat për qëllim të kërkimit dhe zhvillimit bashkërisht i ka realizuar ekipi, organizata apo ndërmarrësi, gjegjësisht aktivitetet të cilat palët e marrëveshjes bashkërisht i kanë besuar palës së tretë, si dhe aktivitetet që janë të ndara ndërmjet palëve të marrëveshjes në bazë të specializimit në zonën e kërkimit dhe zhvillimit apo përdorimit të rezultateve të fituara.

(4) Kërkim i paguar dhe zhvillim sipas paragrafit 2 të këtij neni është kërkim dhe zhvillim që i realizon një palë e marrëveshjes, ndërsa pala tjetër e marrëveshjes siguron mjetet financiare për këtë kërkim e përveç kësaj kjo palë e marrëveshjes përveç financimit nuk realizon asnjë aktivitet tjetër lidhur me këtë kërkim dhe zhvillim.

(5) Përjashtimi grupor për marrëveshjet për kërkim dhe zhvillim nga paragrafi 2 i këtij neni zbatohet edhe në marrëveshjet për kërkim dhe zhvillim që përmbajnë dispozita me të cilat i ndahen apo i licencohen të drejtat e pronësisë intelektuale njëerës apo më shumë palëve të marrëveshjes, gjegjësisht palës së tretë të cilën palët e kanë themeluar për të zbatuar kërkimin dhe zhvillimin e përbashkët, kërkimin e paguar dhe zhvillimin apo përdorimin e përbashkët të rezultateve të kërkimit dhe zhvillimit, me kusht që dispozitat mbi ndarjen apo licencimin nuk përbëjnë objektin primar të këtyre marrëveshjeve, por janë të lidhura drejtpërdrejt dhe të domosdoshme për zbatimin e tyre.

(6) Marrëveshja për specializim nga paragrafi 1, pika b) e këtij neni është marrëveshje horizontale e arritur ndërmjet dy apo më tepër ndërmarrësve të pavarur, me të cilën janë të rregulluar kushtet me të cilët këta ndërmarrës që janë konkurrent në tregun përkatës specializohen në prodhimin e produkteve, dhe mund të jene:

a) marrëveshje të njëanshme për specializim, në bazë të të cilave një palë e marrëveshjes obligohet që të ndalojë prodhimin e produkteve të caktuara apo të përmbahet nga prodhimi i këtyre produkteve, gjegjësisht obligohet që të blejë këto produkte nga pala tjetër e marrëveshjes, ndërsa pala tjetër e marrëveshjes obligohet të prodhojë dhe të shpërndajë këto produkte,

b) marrëveshje të ndërsjella (reciproke) për specializim, në bazë të të cilave dy apo më tepër palë të marrëveshjes në bazë të reciprocitetit në tërësi apo pjesërisht ndalojnë apo përmbahen nga prodhimi i produkteve të caktuar, por të ndryshëm, dhe blejnë këto produkte nga palët tjera të marrëveshjes të cilat obligohen të prodhojnë dhe të shpërndajnë këto produkte,

c) marrëveshje për prodhim të përbashkët, në bazë të të cilave dy apo më tepër palë të marrëveshjes prodhojnë bashkërisht produkte të caktuara.

(7) Përjashtimi grupor për marrëveshjet për specializim nga paragrafi 6 i këtij neni zbatohet edhe në marrëveshjet për specializim që përmbajnë dispozita më të cilat u ndahen apo licencohen të drejtat e pronësisë intelektuale njëra apo më tepër palëve të marrëveshjes, me kusht që këto dispozita nuk përbëjnë objektin primar të këtyre marrëveshjeve, por janë të lidhura drejtpërdrejt dhe të domosdoshme për zbatimin e tyre.

(8) Të drejtat e pronësisë intelektuale nga paragrafët 5 dhe 7 të këtij neni janë të drejta të pronësisë industriale, të drejta autoriale dhe të përafërta.

(9) Palë të marrëveshjes nga paragrafët 2, 5, 6 dhe 7 të këtij neni konsiderohen palët e marrëveshjes dhe ndërmarrësit e tyre të ndërlidhur.

Marrëveshjet në të cilat nuk zbatohet përjashtimi grupor

Neni 4

Në bazë të këtij Udhezimi Administrativ nuk mund të përjashtohen nga ndalimi i përgjithshëm nga neni 4, paragrafi 1 i Ligjit:

a) marrëveshjet horizontale që nuk janë të harmonizuara me këtë Udhezim Administrativ,

b) marrëveshjet horizontale në të cilat nuk zbatohen rregulla tjera për përjashtim grupor nga neni 5, dhe 7A paragrafi 2 i Plotësim ndryshimit të ligjit nr.04/L-226.

II. KUSHTET QË DUHET TË PËRMBAJNË MARRËVESHJET HORIZONTALE DHE KUSHTET TJERA QË DUHET PLOTËSUAR

Kushtet që duhet plotësuar marrëveshjet për kërkim dhe zhvillim

Neni 5

(1) Përjashtimi grupor zbatohet në marrëveshjet për kërkim dhe zhvillim nga neni 3, paragrafi 1, pika a) e këtij Udhezimi Administrativ me kusht që marrëveshjet të plotësojnë këto kushte:

a) të gjitha palët e marrëveshjes duhet të kenë qasje të plotë në rezultatet e kërkimit dhe zhvillimit të përbashkët apo kërkimit të paguar dhe zhvillimit, duke përfshirë të gjitha të drejtat e dala të pronësisë intelektuale dhe njohuritë e përvojat e veçanta (*know-how*), me qëllim të kërkimit, zhvillimit dhe përdorimit të mëtutjeshëm të rezultateve të këtij kërkimi dhe zhvillimi edhe atë menjëherë pasi rezultatet të jenë të qasshëm. Palët e marrëveshjes, në përputhje me këtë Udhezim Administrativ mund të kufizojnë të drejtat e tyre në qasje ndaj rezultateve me qëllim të përdorimit të këtyre rezultateve, veçanërisht nëse këto palë specializohen vetëm për një mënyrë të caktuar të përdorimit të rezultateve. Institutet kërkimore, trupat akademike apo ndërmarrësit që ofrojnë kërkime dhe zhvillim si shërbim komercial dhe zakonisht nuk janë aktiv në përdorimin e rezultateve të këtij kërkimi dhe zhvillimi, mund të merren vesh që të kufizojnë përdorimin e tyre të rezultateve me qëllim të kërkimit të mëtutjeshëm. Me marrëveshjen për kërkim dhe zhvillim mund të rregullohet që njëra palë t'i jep palës tjetër kompensim për lejm të qasjes në rezultate me qëllim të kërkimit apo përdorimit të mëtutjeshëm, por kompensimi i kontraktuar nuk guxon të jetë në lartësi që do të pengojë këtë qasje,

b) secila palë e marrëveshjes duhet të ketë qasje në çdo njohuri dhe përvojë të veçantë paraprake ekzistuese (*know-how*) të ndërmarrësve tjerë, nëse kjo njohuri dhe përvojë e veçantë (*know-how*) është e domosdoshme për përdorimin e këtyre rezultateve kur marrëveshja për kërkim dhe zhvillim siguron vetëm kërkim dhe zhvillim të përbashkët apo kërkim të paguar dhe zhvillim. Me marrëveshjen për kërkim dhe zhvillim palët mund të rregullojnë dhënien e ndërsjellë të kompensimit për qasje në njohurinë dhe përvojën e veçantë paraprake ekzistuese (*know-how*), por kompensimi i kontraktuar asnjëherë nuk guxon të jetë në lartësi që do të pengojë këtë qasje,

c) çdo përdorim i përbashkët duhet të ndërlihet me rezultatet të cilët janë të mbrojtur me të drejtën e pronësisë intelektuale apo paraqesin njohuri dhe përvoja të veçanta (*know-how*), të cilat në mënyrë të konsiderueshme kontribuojnë në avancimin teknologjik dhe ekonomik, dhe këto rezultate duhet të jenë vendimtar për prodhimin e produkteve të kontraktuar apo për zbatimin e teknologjive të kontraktuara,

d) ndërmarrësit që janë obliguar në prodhimin e produkteve të kontraktuara nëpërmjet specializimit, janë të obliguar që të kryejnë të gjitha porositë nga të gjitha palët tjera të marrëveshjes me qëllim të furnizimit të tyre, përveç në rastet kur marrëveshja për kërkim dhe zhvillim njëkohësisht parasheh distribuimin e përbashkët, gjegjësisht kur palët e marrëveshjes kanë rënë dakord që këto produkte mund t'i distribuojë vetëm pala që prodhon produktet e kontraktuara.

(2) Marrëveshja për kërkim dhe zhvillim, në kuptim të paragrafit 1, pika b) e këtij neni, konsiderohet përvetësimi i njohurive dhe përvojave të veçanta (*know-how*) që kanë të bëjnë me produktet, teknologjitë apo proceset dhe zbatimin e analizave teorike, studimit sistematik apo eksperimentimit, duke përfshirë edhe prodhimin eksperimental, testimet teknike të prodhimit apo procesit, vendosjen e objekteve të domosdoshëm dhe përfitimin e të drejtave të pronësisë intelektuale për rezultatet e fituara.

(3) Përdorimi i rezultateve, në kuptim të paragrafit 1, pika c) e këtij neni, konsiderohet prodhimi apo distribuimi i produkteve të kontraktuar, apo zbatimimi i teknologjive të kontraktuara, gjegjësisht ndarja apo licencimi i të drejtave të pronësisë intelektuale ose transmetimi i njohurive dhe përvojave të veçanta (*know-how*) të domosdoshme për këtë prodhim apo zbatim.

(4) Specializimi në kuptim të paragrafit 1, pika d) e këtij neni nënkupton dakordimin reciprok të palëve të marrëveshjes mbi ndarjen e detyrave të caktuara siç janë prodhimi apo distribuimi, gjegjësisht mbi kufizimet që u imponohen palëve të caktuara të marrëveshjes, e që janë të ndërlidhur me përdorimin e rezultateve të kërkimit dhe zhvillimit siç janë kufizimet në aspekt të territoreve, blerësve apo zonave të caktuara të përdorimit. Ky term përfshin situatën në të cilën vetëm një palë e marrëveshjes prodhon dhe distribuon produktet e kontraktuar në bazë të licencës ekskluzive, e cila iu është ndarë kësaj pale nga palët tjera të marrëveshjes.

(5) Specializimi në kuptim të paragrafit 1, pika a) e këtij neni, nënkupton që secila palë e inkuadruar në aktivitetet e kërkimit dhe zhvillimit që janë të përfshira në marrëveshjen për kërkim dhe zhvillim, kështu që palët ndajnë ndërmjet vete punën në kërkim dhe zhvillim në mënyrën që ata e konsiderojnë më të përshtatshme. Ky term nuk përfshin kërkimin e paguar dhe zhvillimin.

(6) Me njohuri dhe përvoja të veçanta (*know-how*), në kuptim të paragrafit 1, pikat b) dhe c) dhe paragrafëve 2 dhe 3 të këtij neni, konsiderohet pakaja e informacioneve praktike jo të patentuar që rrjedh nga përvojat dhe testimet, e gjithashtu është e fshehtë, e rëndësishme dhe e dallueshme. E fshehtë nënkupton që njohuritë dhe përvojat e veçanta (*know-how*) si tërësi apo konfigurim preciz dhe bashkim i pjesëve të tyre nuk janë përgjithësisht të njohura dhe lehtë të arritshme. E rëndësishme nënkupton që

njohuritë dhe përvojat e veçanta (*know-how*) përfshijnë të dhënat, gjegjësisht informacionet që janë të domosdoshme për prodhimin e produkteve të kontraktuar, gjegjësisht për zbatimin e proceseve të kontraktuar. E dallueshme nënkupton që njohuritë dhe përvojat e veçanta (*know-how*) duhet të jenë të prezantuara në mënyrë sa më të kuptueshme, ashtu që të jetë i mundur verifikimi nëse plotësojnë kushtet e fshehtësisë dhe rëndësisë.

(7) Produkti i kontraktuar në kuptim të paragrafit 1, pika c) e këtij neni është produkti i cili është rezultat i kërkimit dhe zhvillimit të përbashkët apo që është prodhuar apo siguruar duke zbatuar teknologjitë e kontraktuara.

(8) Teknologjia e kontraktuar në kuptim të nenit 5 të këtij Udhezimi Administrativ është teknologjia apo procesi që rrjedh nga kërkimi dhe zhvillimi i përbashkët.

Kohëzgjatja e përjashtimit grupor dhe pjesa e tregut për marrëveshjet për kërkim dhe zhvillim

Neni 6

(1) Nëse palët e marrëveshjes nuk janë konkurrentë, përjashtimi grupor për marrëveshjet për kërkim dhe zhvillim nga neni 3, paragrafi 1, pika a) e këtij Udhezimi Administrativ do të zbatohet përgjatë tërë kohës sa zgjasin kërkimi dhe zhvillimi. Në rast të përdorimit të përbashkët të rezultateve të kërkimit dhe zhvillimit, përjashtimi vazhdon të zbatohet në një periudhë prej shtatë vitesh nga vendosja e parë e produktit apo teknologjisë së kontraktuar në tregun përkatës.

(2) Nëse dy apo më tepër palë të marrëveshjes janë konkurrentë, përjashtimi grupor për marrëveshjet për kërkim dhe zhvillim do të zbatohet në periudhën e përcaktuar në paragrafin 1 të këtij neni, nën kushtet e mëposhtme:

a) pjesa e përbashkët e tregut e palëve të marrëveshjes nuk guxon të jetë më e madhe se 25% e tregut përkatës të produktit dhe teknologjisë në rast të marrëveshjeve për kërkim dhe zhvillim të përshkruara në nenin 3, paragrafi 2, pikat a), b) dhe c) të këtij Udhezimi Administrativ,

b) pjesa e përbashkët e tregut e palëve të marrëveshjes, e cila përfshin palën që financon kërkimin dhe zhvillimin dhe të gjithë palët tjera me të cilat kjo palë ka arritur marrëveshje për kërkim dhe zhvillim për produktet dhe teknologjitë e njëjta të kontraktuara, nuk guxon të jetë më e madhe se 25% të tregut përkatës të produktit dhe teknologjisë në rast të marrëveshjeve për kërkim dhe zhvillim të përshkruara në nenin 3, paragrafi 2, pikat d), e) dhe f) të këtij Udhezimi Administrativ.

(3) Pas skadimit të periudhës nga paragrafi 1 i këtij neni, përjashtimi grupor do të vazhdojë të zbatohet në marrëveshjet për kërkim dhe zhvillim për sa kohë që pjesa e përbashkët e tregut të palëve të marrëveshjes nuk do të jetë më e madhe se 25% e tregut përkatës të produktit dhe teknologjisë.

(4) Nëse pjesa e tregut nga paragrafi 2 i këtij neni në momentin e arritjes së marrëveshjes për kërkim dhe zhvillim nuk është më e madhe se 25%, dhe me pas rritet mbi këtë vlerë, jo më shumë se 30%, përjashtimi grupor në marrëveshjet për kërkim dhe zhvillim do të vazhdojë të zbatohet përgjatë periudhës prej dy vitesh të njëpasnjëshme kalendarike pas vitit në të cilin për herë të parë është rritur pjesa e tregut mbi 25%.

(5) Nëse pjesa e tregut nga paragrafi 2 i këtij neni në momentin e arritjes së marrëveshjes për kërkim dhe zhvillim nuk është më e madhe se 25%, dhe më pas rritet në më shumë se 30%, përjashtimi grupor në marrëveshjet për kërkim dhe zhvillim do të vazhdojë të zbatohet në një periudhë prej një viti kalendarik pas vitit në të cilin për herë të parë është rritur pjesa e tregut mbi 30%.

(6) Përjashtimi në kuptim të paragrafëve 4 dhe 5 të këtij neni nuk mund të akumulohet me qëllim të zgjatjes së periudhës së përjashtimit në më tepër se dy vite kalendarike.

Llogaritja e pjesës së tregut për marrëveshjet për kërkim dhe zhvillim

Neni 7

(1) Pjesa e tregut e palëve të marrëveshjes për kërkim dhe zhvillim, në kuptim të nenit 6 të këtij Udhezimi Administrativ, përllogaritet në bazë të vlerës së të ardhurave nga shitja e produktit dhe teknologjisë që janë objekt i marrëveshjes dhe i produkteve të tyre zëvendësuese, gjegjësisht të teknologjisë së tyre në treg. Nëse të dhënat për vlerën e të ardhurave të produkteve, gjegjësisht teknologjia në treg nuk janë të arritshme, për qëllime të përcaktimit të pjesës së tregut të palëve të marrëveshjes për kërkim dhe zhvillim mund të përdoren vlerësime të bazuara në të dhëna të tjera të besueshme të tregut, duke përfshirë sasinë e produkteve të shitura, gjegjësisht teknologjitë që janë objekt i marrëveshjes dhe produkteve të tyre zëvendësuese, gjegjësisht teknologjive zëvendësuese në tregun përkatës.

(2) Pjesa e tregut e ndërmarrësve nga paragrafi 1 i këtij neni llogaritet në bazë të të dhënave që kanë të bëjnë me vitin kalendarik që i paraprin arritjes së marrëveshjes.

(3) Pjesës së tregut të ndërmarrësve nga paragrafi 1 i këtij neni i shtohet edhe pjesa e tregut të ndërmarrësve të ndërlidhur me palët e marrëveshjes e realizuar në mënyrën e përcaktuar në paragrafët 1 dhe 2 të këtij neni.

Kushtet që duhet të përmbajnë marrëveshjet për specializim

Neni 8

(1) Përjashtimi grupor në marrëveshjet për specializimin nga neni 3, paragrafi 1, pika b) e këtij Udhezimi Administrativ zbatohet në rastin kur:

- a) palët në marrëveshje pranojnë obligimin e blerjes ekskluzive dhe/apo furnizimit ekskluziv, ose
- b) palët në marrëveshje nuk i shesin në mënyrë individuale produktet që janë objekt i marrëveshjes për specializim, por ato bashkërisht distribuojnë këto produkte.

(2) Obligimi i blerjes ekskluzive në kuptim të paragrafit 1, pika a) e këtij neni nënkupton obligimin për blerjen e produktit që ka të bëjë me marrëveshjen për specializim vetëm nga pala e kësaj marrëveshje.

(3) Obligimi i furnizimit ekskluziv në kuptim të paragrafit 1, pika a) e këtij neni nënkupton obligimin e furnizimit të palëve të marrëveshjes për specializim me produktet që janë objekt i marrëveshjes për specializim, gjegjësisht një obligim i tillë përjashton mundësinë e furnizimit me produktet që janë objekt i marrëveshjes për specializim të ndërmarrësve që janë konkurrentë të palës së kësaj marrëveshje.

(4) Distribuimi i përbashkët në kuptim të paragrafit 1, pika b) e këtij neni nënkupton distribuimin e organizuar në mënyrë të tillë që:

a) palët e marrëveshjes për specializim distribuojnë produktet që janë objekt i marrëveshjes për specializim nëpërmjet një ekipi, organizate ose ndërmarrësi të përbashkët, ose

b) palët e marrëveshjes për specializim emërojnë një palë të tretë për distributor ekskluziv ose jo-ekskluziv, me kusht që pala e tretë e emëruar të mos jetë konkurrent i palëve të marrëveshjes për specializim.

Pjesa e tregut për marrëveshjet për specializim

Neni 9

(1) Përfshirja grupor për marrëveshjet për specializim nga neni 3, paragrafi 1, pika b) e këtij Udhezimi Administrativ zbatohet me kusht që pjesa totale e tregut e palëve të marrëveshjes në tregun përkatës të mos jetë më e madhe se 20%.

(2) Nëse pjesa e tregut e palëve të marrëveshjes në momentin e arritjes së marrëveshjes nuk është më e madhe se 20% dhe më pas rritet mbi këtë vlerë, jo më shumë se 25%, përfshirja do të vazhdojë të zbatohet përgjatë periudhës prej dy vitesh të njëpasnjëshme kalendarike pas vitit në të cilin për herë të parë është rritur pjesa e tregut mbi 20%.

(3) Nëse pjesa e tregut e palëve të marrëveshjes në momentin e arritjes së marrëveshjes nuk është më e madhe se 20% dhe më pas rritet në më shumë se 25%, përfshirja do të vazhdojë të zbatohet në periudhën prej një viti kalendarik pas vitit në të cilin për herë të parë është rritur pjesa e tregut mbi 25%.

(4) Përfshirja në kuptim të paragrafit 2 dhe 3 të këtij neni nuk mund të akumulohet me qëllim të zgjatjes së periudhës kohore të përfshirjes në më tepër se 2 vite kalendarike.

Llogaritja e pjesës së tregut për marrëveshjet për specializim

Neni 10

(1) Pjesa e tregut e palëve të marrëveshjes për specializim në kuptim të nenit 9 të këtij Udhezimi Administrativ llogaritet në bazë të vlerës së të ardhurave nga shitja e produkteve që janë objekt i marrëveshjes dhe produkteve të tyre zëvendësuese në treg. Nëse të dhëna mbi vlerën e të ardhurave të produktit në treg nuk janë të arritshme, me qëllim të përcaktimit të pjesës së tregut të palëve të marrëveshjes për specializim mund të aplikohen vlerësimet e bazuara në të dhëna të tjera të besueshme të tregut, duke përfshirë sasinë e produkteve të shitura që janë objekt i marrëveshjes dhe produkteve të tyre zëvendësuese në tregun përkatës.

(2) Pjesa e tregut nga paragrafi 1 i këtij neni llogaritet në bazë të të dhënave që kanë të bëjnë me vitin kalendarik që i paraprin arritjes së marrëveshjes.

(3) Pjesës së tregut të palëve të marrëveshjes për specializimin nga paragrafi 1 i këtij neni i shtohet edhe pjesa e tregut të ndërmarrësve nën kontrollin e tyre e realizuar në mënyrën e përcaktuar në paragrafët 1 dhe 2 të këtij neni.

III. KUFIZIMET, GJEGJËSISHT KUSHTET TË CILËT MARRËVESHJET HORIZONTALE NUK DUHET TË PËRMBAJNË

Kufizime të rënda për konkurrencën e tregut në marrëveshjet për kërkim dhe zhvillim

Neni 11

(1) Përjashtimi grupor nuk mund të zbatohet në marrëveshjet për kërkim dhe zhvillim që, drejtpërdrejt apo në mënyrë të tërthortë, në mënyrë të pavarur ose bashkërisht me faktorë tjerë nën kontrollin e palëve kontraktuese përmbajnë kufizime që kanë për qëllim:

a) kufizimin e lirisë të palëve të marrëveshjes në zbatimin e kërkimit dhe zhvillimit në mënyrë të pavarur ose të përbashkët me palët e treta, në një zonë që nuk është në lidhje me zonën e mbuluar nga marrëveshja për kërkim dhe zhvillim ose në një zonë të përafërt,

b) kufizimin e prodhimit apo shitjes,

c) marrëveshjen mbi çmimet me rastin e shitjes së një produkti të kontraktuar ose licencimit të teknologjive të kontraktuara palëve të treta,

d) kufizimin e territoreve në të cilat, gjegjësisht blerësve të cilëve palët mund t'i shesin produktet e kontraktuara në mënyrë pasive apo të licencojnë teknologjitë e kontraktuara,

e) vendosjen e kushteve me anë të cilëve kufizohet ose ndalohet shitja aktive e produkteve të kontraktuar ose teknologjive të kontraktuara në territore ose blerësve që nuk i janë ndarë ekskluzivisht njëri nga palët e marrëveshjes nëpërmjet një specializimi, të rregulluar me nenin 5, paragrafi 4 të këtij Udhezimi Administrativ.

f) vendosjen e kushteve me anë të cilëve refuzohet kërkesa e blerësve në territoret e palëve të marrëveshjes mbi kërkimin dhe zhvillimin, ose blerësve të shpërndarë në një mënyrë tjetër ndërmjet palëve të asaj marrëveshje, përmes specializimit, që do të shisnin produktet e kontraktuar jashtë tregut përkatës,

g) vendosjen e kushteve me anë të cilëve përdoruesve ose stërshitësve u vështirësohet furnizimi me produkte të kontraktuar nga stërshitës të tjerë në Republikën e Kosovës.

(2) Nuk do të konsiderohet kufizime të ndaluara të konkurrencës së tregut në kuptim të paragrafit 1, pika b) e këtij neni, dispozitat në marrëveshjet mbi kërkimin dhe zhvillimin në të cilat:

a) përcaktohen qëllimet e prodhimit, ku përdorimi i përbashkët i rezultateve përfshin prodhimin e përbashkët të produkteve të kontraktuar,

b) përcaktohen qëllimet e të ardhurave të shitjes, ku përdorimi i përbashkët i rezultateve përfshin distribuimin e përbashkët të produkteve të kontraktuar apo licencimin e përbashkët të teknologjive të kontraktuara, ku termi i përbashkët nënkupton kryerjen e punëve nga një ekip, organizatë ose ndërmarrës i përbashkët, gjegjësisht kur punët iu janë besuar bashkërisht një pale të tretë,

c) kufizohen liritë e palëve të marrëveshjes në prodhimin, shitjen, ndarjen apo licencimin e produkteve, teknologjive ose proceseve që janë konkurruese me produktet e kontraktuar apo teknologjitë e kontraktuara gjatë periudhës në të cilën palët e marrëveshjes për kërkim dhe zhvillim kanë rregulluar përdorimin e përbashkët të rezultateve.

(3) Nuk do të konsiderohen si kufizime të ndaluara të konkurrencës së tregut, në kuptim të paragrafit 1, pika c) e këtij neni, dispozitat në marrëveshjet për kërkim dhe zhvillim me anë të cilave përcaktohen çmimet që i ngarkohen blerësve të drejtpërdrejtë apo marrëveshjet për kompensimet të licencës që i ngarkohen të licencuarve të drejtpërdrejtë, edhe atë në rastet kur përdorimi i përbashkët i rezultateve përfshin distribuimin e përbashkët të produkteve të kontraktuar apo licencimin e përbashkët të teknologjive të kontraktuara, ku termi i përbashkët nënkupton kryerjen e punëve nga një ekip, organizatë ose ndërmarrës i përbashkët, gjegjësisht kur punët iu janë besuar bashkërisht një pale të tretë.

(4) Nuk do të konsiderohen si kufizime të ndaluara të konkurrencës së tregut, në kuptim të paragrafit 1, pika d) e këtij neni dispozitat në marrëveshjet për kërkim dhe zhvillim me anë të cilave kufizohet licencimi i teknologjisë së kontraktuar, me kusht që rezultatet të jenë ekskluzivisht të licencuara për një palë tjetër të marrëveshjes.

(5) Shitja pasive nënkupton reagimin ndaj kërkesave të blerësve individualë që gjenden në zonat e rezervuara për palët tjera të marrëveshjes, duke përfshirë shpërndarjen e produkteve tek blerësit e këtyllë, por ky reagim nuk guxon të jetë rezultat i veprimit të shitjes aktive. Shitje pasive gjithashtu konsiderohet reklamim i përgjithshëm apo reklamimi në media apo në internet që arrijnë në zonat e rezervuara për palët tjera të marrëveshjes, gjegjësisht për blerësit që gjenden në ato zona, që rezultojnë nga zhvillimi i teknologjisë ose lehtësia e qasjes, kështu që konsiderohet një mënyrë e arsyeshme e qasjes tek këta blerës.

(6) Shitja aktive nënkupton kërkimin dhe qasjen aktive tek blerësit ose tek një grup i caktuar i blerësve të cilët gjenden në një zonë të rezervuar për palët tjera të marrëveshjes, arritjen e kontratave individuale dhe marrjen e masave për të ofruar produkte për këta blerës, themelimin e filialeve, depove apo organizimin e një rrjeti shpërndarës dhe promovimin në atë zonë. Qasja aktive konsiderohet edhe vizita tek blerësit, dërgimi i postës tek blerësit, duke përfshirë edhe postën elektronike, reklamim në mediat dhe mjete të tjera të informimit publik që kanë si shënjestër ekskluzivisht këta blerës ose një grup blerësish të cilët gjenden në një zonë të rezervuar për palët tjera të marrëveshjes.

Obligimet e ndaluara në marrëveshjet për kërkim dhe zhvillim

Neni 12

Përrjashtimi grupor nuk mund të zbatohet ndaj obligimeve në vijim, të përfshira në marrëveshjet për kërkim dhe zhvillim:

(a) ndalimin e kontestimit të vlefshmërisë të të drejtave të pronësisë intelektuale mbajtësit e të cilave janë palë në marrëveshjen për kërkim dhe zhvillim dhe që janë relevante për kërkim dhe zhvillim pas përfundimit të atij kërkimi dhe zhvillimi, apo ndalimin e kontestimit të vlefshmërisë të të drejtave të pronësisë intelektuale, mbajtësit e të cilave janë palë në marrëveshjen për kërkim dhe zhvillim dhe që mbrojnë rezultatet e këtij kërkimi dhe zhvillimi, pa përrjashtuar ndërprerjen e marrëveshjes për kërkim dhe zhvillim në rast se njëra nga palët e marrëveshjes për kërkim dhe zhvillim konteston vlefshmërinë e këtyre të drejtave të pronësisë intelektuale,

(b) obligimin e ndalimit të dhënies së licencës për një palë të tretë për prodhim të produkteve të kontraktuar ose për të aplikuar teknologji të kontraktuara, përveç nëse marrëveshja parasheh që të paktën njëra nga palët e marrëveshjes përdor rezultatet e kërkimit dhe zhvillimit të përbashkët ose të kërkimit dhe zhvillimit të paguar në tregun në të cilin vepron pala e tretë.

Kufizime të rënda për konkurrencën e tregut në marrëveshjet për specializim

Neni 13

(1) Përrjashtimi grupor nuk mund të zbatohet në marrëveshjet për specializim, që drejtpërdrejt apo në mënyrë të tërthortë, individualisht ose bashkërisht me faktorë të tjerë nën kontrollin e palëve kontraktuese përmbajnë kufizime që kanë për qëllim:

a) përcaktimin e çmimeve gjatë shitjes së produkteve tek palët e treta;

b) kufizimin e prodhimit ose shitjes, apo

c) ndarjen e tregut ose të blerësve.

(2) Nuk do të konsiderohen si kufizime të ndaluara të konkurrencës së tregut në kuptim të paragrafit 1, pika a) e këtij neni dispozitat në marrëveshjet për specializim me anë të cilave përcaktohen çmimet e ngarkuara për blerësit e drejtpërdrejtë nëpërmjet distribuimit të përbashkët në kuptim të nenit 8, paragrafi 4, të këtij Udhezimi Administrativ.

(3) Nuk do të konsiderohen si kufizime të ndaluara të konkurrencës së tregut në kuptim të paragrafit 1, pika b) e këtij neni dispozitat në marrëveshjet për specializim me anë të cilave palët kontraktuese përcaktojnë sasinë e produkteve nëpërmjet marrëveshjeve të njëanshme ose reciproke për specializim nga neni 3, paragrafi 6, të këtij Udhezimi Administrativ ose mbi përcaktimin e kapacitetit dhe vëllimit të prodhimit nëpërmjet marrëveshjes për prodhim të

përbashkët nga neni 3, paragrafi 6, të këtij Udhezimi Administrativ dhe dispozitat me anë të cilëve palët kontraktuese përcaktojnë të ardhurat e synuara të shitjes nëpërmjet distribuimit të përbashkët nga neni 8, paragrafi 4, të këtij Udhezimi Administrativ.

(4) Prodhimi në kuptim të paragrafit 1, pika b) e këtij neni është prodhimi i mallrave ose përgatitja e shërbimeve, ndërsa përfshin edhe prodhimin përmes kooperantëve - nënkontraktuesve.

(5) Përgatitja e shërbimeve në kuptim të paragrafit 4 të këtij neni shënon aktivitetet që janë në rritje në lidhje me ofrimin e shërbimeve ndaj blerësve.

IV. REVOKIMI I PËRJASHTIMIT GRUPOR

Kushtet për revokimin e përjashtimit grupor

Neni 14

(1) Autoriteti Kosovar i Konkurrencës (në tekstin e mëtejshëm: Autoriteti) mund, sipas detyrës zyrtare, në kuptim të nenit 5 të Ligjit dhe - 7A, të Plotësim ndryshimit të Ligjit 04/L-226, të iniciojë procedurën për vlerësimin e një marrëveshjeje të caktuar horizontale, megjithëse kjo marrëveshje i plotëson kushtet për përjashtim grupor sipas këtij Udhezimi Administrativ, në rastet kur efektet e asaj marrëveshjeje, në mënyrë të pavarur ose në mënyrë kumulative me marrëveshje të ngjashme në tregun përkatës, nuk përmbushin në mënyrë kumulative gjatë kohëzgjatjes së tyre kushtet për përjashtim nga neni 5 i Ligjit dhe - 7A të Plotësim ndryshimit të Ligjit 04/L-226.

(2) Nëse Autoriteti në procedurën e vlerësimit të marrëveshjes së caktuar nga paragrafi 1 i këtij neni përcakton që marrëveshja ka efekte që janë në kundërshtim me kushtet e përcaktuara në nenin 5 të Ligjit dhe - 7A, të Plotësim ndryshimit të Ligjit 04/L-226, me anë të një vendimi do të revokojë përjashtimin grupor për atë marrëveshje.

Barra e provës për përmbushjen e kushteve për përjashtim

Neni 15

(1) Për marrëveshjet horizontale që plotësojnë kushtet për një përjashtim grupor nga ky Udhezim Administrativ, zakonisht supozohet se përmbushin kërkesat nga neni 5 të Ligjit dhe - 7A, të Plotësim ndryshimit të Ligjit 04/L-226, përveç rastit nga neni 14 i këtij Udhezimi Administrativ.

(2) Përjashtimisht, për marrëveshjet horizontale të cilat nuk plotësojnë kushtet për një përjashtim grupor nga ky Udhezim Administrativ, palët e marrëveshjeve të këtilla duhet vetë të vlerësojnë nëse marrëveshjet e tyre përmbushin, pavarësisht kësaj kushtet për përjashtimin nga ndalimi i përgjithshëm i marrëveshjes nga neni 5 të Ligjit dhe - 7A, të Plotësim ndryshimit të Ligjit 04/L-226.

(3) Nëse Autoriteti inicion procedurën për përcaktimin e marrëveshjes së ndaluar nga paragrafi 2 i këtij neni, barra e provës për përmbushjen e kushteve për përjashtim nga neni 5 i Ligjit dhe - 7A, i Plotësim ndryshimit të Ligjit 04/L-226, në atë procedurë do të bartet nga ana e ndërmarrësve, palëve të asaj marrëveshje vertikale.

V. DISPOZITA KALIMTARE DHE PËRFUNDIMTARE

Neni 16

Dispozitat kalimtare

Hasja në vështirësi gjatë aplikimit të dispozitave të këtij Udhezimi Administrativ apo mungesa e dispozitave për marrjen e vendimit përfundimtar, duhet të aplikohen dispozitat e ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës, Plotësim ndryshimit të Ligjit 04/L-226, ligjit për procedurën e përgjithshme administrative dhe ligjet tjera që kanë të bëjnë me shkeljen e rregullave të konkurrencës.

Neni 17

Ndryshimi dhe plotësimi i Udhezimit Administrativ

Ndryshimin dhe plotësimin e këtij Udhezimi Administrativ mund ta propozojë çdo anëtar i Komisionit, e cila bëhet në mënyrën dhe procedurën e paraparë për miratimin e saj.

Neni 18

Marrëveshjet horizontale për përjashtimet grupore ndërmjet ndërmarrësve duhet të harmonizohen plotësisht me dispozitat e këtij Udhezimi Administrativ.

Neni 19

Hyrja në fuqi

Ky Udhezim Administrativ hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Komisioni i Autoritetit Kosovar të Konkurrencës.

KOMISIONI I AUTORITETIT KOSOVAR TË KONKURRENCËS

(_____)

Valon Prestreshi

Kryetar

(_____)

Ahmet Krasniqi
Zëvendëskryetar

(_____)

Fatime Haziri
Anëtare

(_____)

Muhamed Krasniqi
Anëtar

(_____)

Shaqir Morina
Anëtar